1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
 - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se ulja e ofertës sonë nga fondi maksimal, i llogaritur në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, **do të jetë jo më pak se përqindja e përcaktuar në tabelën e mëposhtme:**

Lista e Çmimeve (Tabela e uljes së ofertës e shprehur në përqindje)

	GRUPI 1	GRUPI 2	GRUPI 3	GRUPI 4	GRUPI 5
NDERTESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE					
STRUKTURAT NE AMBJENTET E JASHTME					
VEPRAT INXHINIERIKE (NDERTIM)					
VEPRAT INXHINIERIKE (MIREMBAJTJE)					
STRUKTURAT MBAJTESE					
STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT					
SISTEMET TEKNIKE					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Shërbim për mbikëqyrjen e punimeve të zbatimit për nëvojat e KESH sh.a.

Afatet e ekzekutimit: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e marrëveshjes kuadër/ Ose me mbarimin e fondit limit. *Kohëzgjatja e kontratave që do të lidhen në vijim të minitenderave do të përcaktohet sipas termave të referencës për secilin objekt.*

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

1. OBJEKTIVI KRYESOR

Referuar detyrimit ligjor që KESH sh.a. si Shfrytëzues i digave të kaskadës së lumit Drin ka për mirëmbajtjen e hidrocentraleve të Fierzës, Komanit dhe të Vaut të Dejës, referuar Programit Ekonomik dhe Financiar i cili është hartuar në përmbushje edhe të këtij detyrimi ligjor, KESH sh.a. sipas nevojave për zbatimin e projekteve në kuadër të investimeve të mundshme të mirëmbajtjes së veprave që do të realizojë gjatë një periudhe tre vjeçare, do të ketë gjithashtu nevojë edhe për shërbimin e Mbikqyrjes dhe të Kolaudimit të këtyre punimeve.

Objektivi kryesorë i KESH sh.a. është qëllimi i shërbimit të Mbikqyrjes dhe të Kolaudimit të punimeve / investimeve të parashikuara në Programin Ekonomik dhe Financiar të kompanisë. Për këtë KESH sh.a. ka nevojë të kontraktojë disa kompani për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve për kontratat e zbatimit që do të realizojë në Njësitë e Prodhimit Hec Fierzë, HEC Koman, HEC Vau Dejës, SLM Durrës, KESH Qendër, etj.

Për këtë arsye, sipas Legjislacionit të Prokurimeve Publike po zhvillohet kjo procedurë shërbimi “Marrëveshje Kuadër”, që do të lidhet me gjithë operatorët ekonomik që do të kualifikohen.

2. DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKQYRËSIT.

Mbikqyrësi i punimeve të zbatimit për objektet e zbatimit të parashikuara në programin ekonomik dhe financiar të kompanisë, ka për detyrë të drejtojë punimet si Mbikqyrës i tyre, të kontrollojë rigorozisht çdo hap të zbatimit të tyre sipas projekteve të miratuara dhe konform Ligjit Nr. 8402, Datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe kërkesave kontraktuale me investitorin KESH sh.a., ose të kolaudojë punimet e përfunduara sipas të njëjtave kushteve ligjore dhe kontraktuale.

Mbikqyrësi do të duhet të ndjekë dhe ta garantojë drejtimin e punimeve për të siguruar mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, preventivin e punimeve si dhe destinacionin e objektit duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të çdo objekti (afati kohor) dhe anën ekonomike të këtij objekti (vlefata e kontratës). Për këtë do të duhet të mbajë të informuar me raporte periodike të shkruara investitorin KESH sh.a., me MEMO dhe shkresa të veçanta, ose me forma të menjëhershme komunikimi nëse do të ketë problematika.

Në realizimin e objektivave për zbatimet e punimeve mbikqyrësi i punimeve menjëherë pas lidhjes së kontratës duhet:

- Të menaxhojë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të KESH sh.a. dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar, dhe sipas Ligjit Nr 8402

datë 10.09.1998, UKM Nr. 3 datë 15.02.2001, i ndryshuar me udhëzimin Nr. 1, datë 16.06.2011, UKM Nr. 1 datë 22.02.2005, UKM Nr. 2 datë 13.05.2005.

- Të njihet në detaje me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike të tij në veçanti dhe të objektit ku zhvillohen punimet në përgjithësi.
- Të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standarteve të përcaktuara me ligj.
- Të paraqesë pranë KESH sh.a., stafin e tij kyç mbikqyrës.
- Në bazë të volumit të punimeve dhe vlerës së kontratës, Mbikqyresi i punimeve duhet të jetë rezident me kohe pune të plotë në objekt, ndërsa stafi tjetër mbikqyrës mund të jetë rezident në objekt me kohë të pjesëshme.

Mbikqyresi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin, etj.

Mbikqyresi vihet në dijeni nga KESH sh.a për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar. Ai merr në dorëzim kontratën në mes Autoritetit Kontraktor dhe zbatuesit të punimeve për ndekje sipas ligjit dhe këtyre TOR.

Mbikqyresi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me pushtetin lokal në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt dhe insitucionet e tjera pjesmarrës apo aktore në këtë objekt dhe informon për detajet e projektit duke përfshirë shpronësimet në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, spostimet e ndryshme që mund të bëhen në objekt, dhe çdo detaj tjetër projekti që prek, ndikon apo implikon këto institucione apo organizma e tjera të interesuara, njofton për personat kryesor, përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me nenin 9 të ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998.

Mbikqyresi i Punimeve ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave të autorizimeve dhe të lejeve të cilat, sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- Të bëjë verifikimin që punimet kryhen në përputhje me Rregulloren e Sigurimit Teknik.
- Të studiojë dhe verifikojë skemat e paraqitura nga Projektuesi.
- Kontrolli dhe miratimi i materialeve elektrike përpara se të furnizohen në objekt.
- Të marrë pjesë në kontrollin dhe matjen e rezitencës së tokëzimit në objekt.
- Të sigurojë dhe mbikëqyrë se të gjitha punimet elektrike kryhen në përputhje me VKM Nr. 482, datë 17.06.2020 për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”.
- Të njihet me hollësi me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjithë akteve administrative që lidhen me të si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të munshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të verifikojë stafin e sipërmarrësit në objekt, numrin e punonjësve dhe specialistëve sipas kontratës dhe makineritë apo paisjet që kontraktori do të përdorë për përmbushjen e detyrimeve të kontratës.
- Të kontrollojë dhe të ndjekë vendosjen sipas standartit të tabelës së identifikimit të objektit që prokurohet me të dhënat e mëposhtme:

Emërtimi i objektit:

Investitori _____

Projektuesi _____ sh.p.k.

Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik _____ sh.p.k.

Mbikqyrësi _____ sh.p.k.

Afati i ndërtimit të objektit _____ muaj

Vlefëta e objektit _____ lek (me TVSH).

- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke orientuar dhe kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese e të sigurisë, shiritave, fenereve etj., sipas dokumentacionit të vlerësimit të rrezikut udhëzimi nr. 312 dt. 05.05.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe koordinimit (PSK), si dhe sipas VKM Nr. 482, datë 17.06.2020 për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”.
- Të verifikojë dokumentacionin për fillimin e punimeve që duhet të dorëzojë pranë KESH sh.a., ku të përfshihen:
 - Stafit i Sipërmarrësit
 - Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit.
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar.
- Të kontrollojë ecurinë e punimeve duke u bazuar në projekt zbatimin, standartet e miratuara dhe specifikimet teknike si dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka dhe ti propozojë KESH sh.a., zgjidhjet konkrete.
- Të ndjeke në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.
- Të kërkojë të zbatojë në mënyrë korrekte planin e organizimit të punimeve.
- Të kërkojë dhe të zbatojë lejen (autorizimin, pëlqimin) mjedisore, të miratuara nga organi kompetent.
- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme pikëtimin e objektit dhe çdo element tjetër përmbajtësor të projektit të zbatimit sikur mund të jenë kuotat, trashësitë e shtresave (nëse kemi rrugë), kuotat e vendosjes së veprave të artit, etj.
- Të respektojë dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike, arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore.
- Të kontrollojë bazamentin e objektit dhe të japë miratimin e tij për vazhdim të punimeve.
- Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
- Të monitorojë dhe të kontrollojë vendosjen e sinjalistikës së përkohëshme në objekt gjatë zbatimit të punimeve duke u siguruar që këto të bëhen sipas specifikimeve teknike dhe standarteve të miratuara.
- Për çdo punim të maskuar të bëjë fotografimin ose regjistrim e tij dhe të mbaj proces verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit. (formati tip sipas udhëzimit Nr. 1, dt. 16.06.2011, “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr. 3, dt. 15.02.2001”, të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, apo akteve të tjera nënligjore që kanë hyrë apo hyjnë në fuqi gjatë zbatimit të punimeve).

- Në çdo fund dite pune, të kontrollojë ditarin e punimeve dhe të firmos atë (formati tip sipas udhëzimit Nr. 1, dt. 16.06.2011, “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr. 3, dt. 15.02.2001”, të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- Të kontrollojë situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe miratojë ato. (formati tip sipas udhëzimit Nr. 1, dt. 16.06.2011, “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr. 3, dt. 15.02.2001”, të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”).
- Të kontrollojë librin e masave ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimet e tyre (formati tip sipas udhëzimit Nr. 1, dt. 16.06.2011, “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr. 3, dt. 15.02.2001”, të Këshillit të Ministrave, “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, i cili vërteton volumin e punimeve dhe ta miratojë atë.
- Të kontrollojë certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen në objekt të tyre.
- Gjatë zbatimit të projektit, i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit, sa herë që e sheh të nevojshme, dhe sipërmarrësi është i detyruar t’i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë.
- Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projektin dhe Preventivin e parashikuar, Mbikqyrësi i Punimeve, mbasi të bindet vetë dhe të japë miratimin e tij për zgjidhjen teknike, duhet t’i paraqesë KESH sh.a., një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga KESH sh.a.
- Të nënshkruajë aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme.
- Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë KESH sh.a. raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Realizimi i punimeve në vleftë dhe % , afati kohor realizimi i financimit.

Kërkesat e Raportimit.

Mbikqyrësi i Punimeve duhet të paraqesë një Raport me shkrim mujor pranë Investitorit, i cili do të duhet të përmbajë të paktën:

- Hyrje,
- Informacion i përgjithshëm,
- Qëllimi i punimeve,
- Mbikqyrja e punimeve ndërtimore,
- Personeli i siguruar nga Mbikqyrësi,
- Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve,
- Stafi aktual,
- Kohëqëndrimi në objekt për secilin,
- Raportimi,
- Kohëzgjatje e shërbimit të Mbikqyrjes,
- Përshkrimi i Projektit,
- Organizimi i Sipërmarrësit,
- Sipërmarrësi,
- Stafi present,
- Mjete dhe makineri,
- Kohëqëndrimi në objekt,

-
- Progresi mujor i punimeve,
 - Përshkrim të punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave),
 - Fotografi të proceseve të punëve të kryera,
 - Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm,
 - Grafiku i ecurisë së punimeve,
 - a. Të aprovuara
 - b. Të kryera
 - Volumet Progressive të Punimeve Mujore
 - c. Punimet e aprovuara
 - d. Çertifikatat e cilësisë dhe testet laboratorike
 - e. Libreza e masave
 - f. Punimet e kryera por të pa aprovuara
 - g. Situacionet mujore
 - h. Matjet topografike
 - Korespondenca
 - i. Proces-Verbale
 - j. Urdhëra, Udhëzime, Njoftime
 - k. Ndryshime në Projekt dhe Preventiv në se ka (të aprovuara nga KESH sh.a)
 - Moti (kalendarik)
 - Problemet që kanë dalë
 - l. Teknike
 - m. Sociale
 - Konkluzione

Shënim: Raporti Mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje të dorëzohen në KESH sh.a. pranë Ndjekësit të Kontratës (Administratori i Kontratës) që është person i autorizuar nga Autoriteti Kontraktual (Administratori i KESH sh.a.), në Divizionin Teknik, Drejtoritë vartëse të tij DVHT, DEM, NjMP me financim të huaj, ose Njesitë e Prodhimit në HEC-e. Raporti Mujor do t'i dorëzohet KESH sh.a., brenda datës të caktuar në kontratë. Konsulenti do të mbajë kontakte të vazhdueshme me KESH sh.a., (Ndjekësit të Kontratës/Administratori i Kontratës) dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të tyre.

Mbikqyrësi mban përgjegjësi të plotë;

- Në fillim të punimeve Mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e objektit.
- Projektzbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori sëbashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologjor inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet. Kjo vlen për të gjithë punimet e sinjalistikës vertikale dhe horizontale.
- Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Realizimin e punimeve në përputhje me Rregulloren e Sigurimit Teknik dhe VKM Nr. 482, datë 17.06.2020 për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”.
- Saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit apo elektrike sipas rastit.

-
- Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarësit dhe KESH sh.a., për realizimin e të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
 - Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikëqyrësit. Sipërmarësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.
 - Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me KESH sh.a., urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që e kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.
 - Për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon në rast së gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërmirë të Mbikëqyrësit, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërmirë. Investitori kontrollon praninë e Mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij, nxjerrin vendimin për pezullimin e punimeve deri në emërtimin dhe praninë e tij në objekt. Në çdo rast pagesa e mbikëqyrësit të ndërmirë do të bëhen në përlllogaritje të punimeve të mbetura për kryerjen e punimeve të kontraktuara.

Mbikëqyrësi i Punimeve ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të Drejtuesit të Kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
- Të mos pranojë Drejtues Teknik, manovrator, punëtorë në qoftë se këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
- Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarësi me shpenzimet e tij.
- Të marrë dhe të ruajë mostrat e bojës që përdoret për vijëzimet horizontale sipas specifikimeve dhe ka të drejtën që në çdo rast që e shikon të arsyeshme të bëjë provat laboratorike apo të sasisë së vendosur për njësi.
- Të kërkojë çertifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materiale.
- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarësit.
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurta dhe cilësore.
- Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme në qoftë se ato janë jashtë kushteve teknike.
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me proces verbal të analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt zbatimit.
- Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarësit.
- Kur Mbikëqyrësi i Punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarësit. Në rast të kundërt, sipërmarësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

-
- Mbikqyrësi i Punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt dhe Specifikimet Teknike.
 - Mbikqyrësi i Punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose pa aftësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e KESH sh.a., për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas fajit, Mbikëqyrësi së bashku me KESH sh.a. dhe sipërmarrësin, përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
 - Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht KESH sh.a. për gjendjen e tij. Në rast se KESH sh.a. ka vërejtje, e njofton Sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm Mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

Në përfundim të punimeve Mbikëqyrësi:

- Merr njoftimin me shkrim për përfundimin e punimeve brenda 30 ditëve dhe vërteton në proces verbal datën e përfundimit të tyre. Merr në dorëzim dokumentacionin përkatës të punimeve (projektin faktik të zbatuar ku të jenë pasqyruar edhe ndryshimet e mundëshme, praktikatat e ndryshimeve të urdhëruara, etj.
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402 datë 10.09.1998, UKM Nr. 2 datë 13.05.2005 dhe UKM Nr. 3 datë 15.02.2001 i ndryshuar, me udhëzimin Nr. 1 datë 16.06.2011, dokumentacionin teknik e dorëzon pranë KESH sh.a., tek Ndjekësi / Administratori i Kontratës pranë Divizionit Teknik. Njofton gjithashtu edhe Departamentin e Investimeve për përfundimin e punimeve. Ai mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

1. Proces verbal i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
2. Proces verbal për fillimin e punimeve.
3. Kontratën e sipërmarrësit.
4. Kontratën e mbikëqyrjes.
5. Projekt organizimi i punimeve.
6. Projektin e zbatimit.
7. Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korespondencën skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme.
8. Preventivin e ofertës fituese .
9. Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rinj të punimeve negociimin e tyre).
10. Grafikon e punimeve.
11. Specifikimet teknike.
12. Aktin e Piketimit para fillimit të punimeve, ku të përshkruhet çdo mospërputhshmëri e mundëshme, para fillimit të punimeve.
13. Dokumentacionin topografik, gjeologjik inxhinjerik, elektrik (spas rastit).
14. Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme.

-
15. Proces-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga Drejtuesi Teknik dhe Mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.
 16. Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga Mbikëqyrësi.
 17. Libreza e masave.
 18. Shkresën e mbikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë shoqëruar me dokumentacionin perkates.
 19. Proces verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (Drejtuesi Teknik) dhe Mbikëqyrësi.
 20. Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi(drejtusi teknik) dhe mbikqyrësi.
 21. Situacion i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi(drejtusi teknik) dhe mbikqyrësi.
 22. Çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe testet laboratorike te materialeve te përdorur në objekt
 23. Miratim i materialeve të përdorura nga Mbikqyrësi.
 24. Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar.
 25. Regjistri i kontabilitetit.
 26. Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik.
 27. Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve.
 28. Proces verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar.
 29. Relacionin përfundimtar i mbikqyrësit

(formatet tip të dokumentacionit të jenë sipas formatit tip në udhëzimin Nr.1 dt 16.06.2011 për disa ndryshime në udhëzimin Nr. 3, dt. 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit (të ndryshuar).

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e tij. Ky dokumentacion është në tre kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë Kolaudatorit ose grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër nga KESH sh.a., brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen pranë KESH sh.a. tek Kolaudatori apo Grupi i Kolaudimit pranë KESH sh.a. duhet të jenë origjinale.

Mbikqyrësi i Punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet Kolaudatorit apo Grupit të Kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos Proces-Verbalin dhe Aktin e Kolaudimit.

Pas përfundimit të kolaudimit, Mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për të likuiduar KESH sh.a.

3. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKQYRJES SË PUNIMEVE

Afatet e këtij shërbimi do të jenë për të gjithë periudhën e zbatimit të punimeve. KESH sh.a. ka të drejtë të kërkojë ti ndryshojë këto afate kur kërkon largimin e Mbikqyrësit në rast se vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

-
- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
 - Ndërprerje e pa arsyeshmë e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
 - Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuar, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike.

Kur verëhen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të urdhërojë Mbikqyresin e Punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të legjislacionit në fuqi.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sa më sipër.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate..

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Liçencën e Shoqërisë për mbikqyrje punimesh zbatimi në ndërtim, të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj, në kategoritë si më poshtë:

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP - 1 Punime gjurmimi në tokë.

NP - 2 Ndërtime civile dhe industriale

NP -3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

NP - 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP - 5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti

NP – 6/b Diga të vogla (diga me lartësi deri 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion m³ ose gjatësi kurore dige deri 500 ml)

NP -7/a Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

NP -8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë

NP - 9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP-11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

NP -12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS - 1 Punime për prishjen e ndërtimeve.

NS - 2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre

NS- 3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

NS - 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

NS - 6 Sinjalistika rrugore jondriçuese

NS - 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore

NS - 9 Punime strukturore speciale.

NS - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

NS - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni








NS - 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

NS-15 Pastrimi i ujërave detarë, liqenorë dhe lumorë

NS - 18 Punime topogjeodezike.

NS - 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

